



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 08.05.2026

Komuna e Fushë Kosovës, bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 19, nenin 21, nenin 22, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 28, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenin 17, paragrafi 17.1, shkronja (ç, ë) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 149, të datës 04.05.2026 shpallë këtë:

NJOFTIM

**Për konsultim publik për Projekt-Rregullore për ndarjen e subvencioneve nga
Komuna e Fushë-Kosovës**

Njoftimi për konsultim publik lidhur me 'Projekt-Rregullore për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës', është i hapur nga data: **08.05.2026 deri më datën 22.05.2026**.

Projekt-Rregullore për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, është e publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës

Komentet, sugjerimet apo vërejtjet lidhur me projekt-aktin normativ, mund t'i adresoni përmes adresave elektronike si vijon: adriatik.zeqiri@rks-gov.net dhe hasan.gjyrevci@rks-gov.net

Komuna e Fushë-Kosovës e ka paraparë edhe një takim të Konsultimit Publik, i cili do të mbahet me datën: **20.05.2026, me fillim prej orës 14:00h** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Me respekt,

Kryetari i Komunës
Valon Prebreza

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Relat/Dr. nr. 149
Datë/Datum. 04.05.2026

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës', të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, e cekur në paragrafin një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të kushteve dhe kriterëve për ndarjen e subvencioneve nga komuna.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimeve publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë e Komunës, që bëjnë ndarje të subvencioneve.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtoritë e të Komunës dhe Arkivës

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Në bazë nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në zbatim në nenin 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i Parave Publike dhe nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2026, miraton këtë:

PROJEKT-RREGULLORE

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NGA KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qellimi

Kjo rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të personave fizik dhe juridik me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të projekteve dhe aktiviteteve të personave fizik dhe juridik që janë në interes publik në komunën e Fushë Kosovës, sipas procedurës së përshkruar në këtë rregullore.

Neni 2

Perkufizimet

Rregullore- është akt që miratohet nga numri i kërkuar i anetareve të Kuvendit të Komunes që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të tij.

Subvencionet- në kuptim të kësaj rregulloreje, subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rjedhëse të përfituesve, të ardhurat.

Personat Juridik- nënkupton ndërmarrjen, entin, shoqatën, klubin etj. Me identitet sipas të dhenave të regjistrave të personave juridik.

Personat Fizik- nënkupton qytetarin me identitet sipas të dhenave të regjistrave të gjendjes civile.

Perfituesi - nënkupton personat fizike dhe juridike që perfitojne mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e komunës dhe në pajtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore.

Thirrja publike – nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve.

Mbështetja Financiare – nënkupton çdo formë e mbështetjes për persona fizik dhe juridik, e cila shprehet në vlerë monetare, pa marrë parasysh emërtimin e saj.

Komisioni- në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton komisionin përkatës të themeluar nga Kryetari i Komunes.

Neni 3

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin fiskal, për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

1.1 Komuna ndan subvencione për këto fusha: Drejtoria e arsimit, Drejtoria e zvillimit ekonomik, Drejtoria për bujqësi, Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Drejtoria për kulturë, rinë dhe sport, siguri, Kabineti i Kryetarit si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera.

1.2. Ndarja e subvencioneve sipas kësaj rregulloreje do të zbatohet për të gjitha rastet, ashtu siç është paraparë në nenin 2, pikë 5 të Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 4

Subjektet perfituese të subvencioneve

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizike, OJQ-te dhe në raste të veçanta personat juridikë që ndërlidhen me ndonjë aktivitet nga fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjate ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të komunes, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

Këto procedura zhvillohen në pajtim me Rregulloren MF-nr-04/2017, si dhe me dispozitat e parapara të kësaj rregulloreje.

3. Ndarja e subvencioneve sipas kërkesave të veçanta aplikohet për kategorinë e subvencioneve të cilat i ndan Kryetari i Komunes, në të gjitha fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

4. Perfitues të subvencioneve të ndara nga komuna nuk mund të jenë personat fizike jorezidente të Komunes së Fushe Kosovës.

5. Asnjë subjekt nuk mund të jetë perfitues i subvencioneve, nëse paraprakisht nuk e ka mbyllur subvencionin paraprak në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratën për ndarjen e subvencioneve.

Neni 5

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 1.1 bursa për studente;
- 1.2 kuadro deficitare;
- 1.3 Studentet në gradën e doktoratës;
- 1.4 nxënës me nevojë të veçanta;

2 botimin e librave/revistave;

3 Subvencionimin e aktiviteteve tjera me karakter edukativ arsimor siq janë:

1. Trajnime,
2. Gara të brendshme dhe ndërkombëtare,
3. Femijet me inteligjencë të lartë që janë pjesëmarrës në gara ndërkombëtare.

1.2.Format e subvencioneve;

- Dhenja falas e teksteve shkollore dhe
- Rimbursimi financiar për blerjen e librave për studentët në gjendje të rëndë ekonomike.

2. Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve:

2.1 Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të qarta për dënimin e subvencioneve duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 2.1.1 notën mesatare
- 2.1.2 numrin e studentëve/nxënësve në familje;
- 2.1.3 kategoritë e dalës nga lufta (vetëm për studentët);
- 2.1.4 gjendja ekonomike
- 2.1.5 mungesën e prindërve të studentit;
- 2.1.6 aftësinë e kufizuar të studentit.

2.2 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë:

- 2.2.1 dokumentin e identifikimit;
 - 2.2.2 certifikaten e notave;
 - 2.2.3 certifikaten e vitit kalendarik te studimeve;
 - 2.2.4 certifikaten e vendbanimit;
 - 2.2.5 dëshmine mbi gjendjen ekonomike;
 - 2.2.6 dëshminë se prinderit i perkasin kategorive te dala nga lufta;
- 2.3. Komuna duhet te bëjë shpalljen publike per dhenien e bursave, e cila publikohet ne ueb-faqen e komunës, mediet sociale dhe ne medie lokale.
3. Shumat e subvencionimit te parapara me këtë nen do te percaktohen me thirrjen publike sipas drejtorise perkatese dhe të miratuara nga Kryetari i Komunes.
4. Përfituesit e subvencioneve sipas këtij neni, duhet te jenë banorë të Komunes së Fushe Kosoves

Neni 6

Subvencionet per zhvillim ekonomik

1. Subvencionet per fushen e zhvillimit ekonomik dhe rural ndahen per te promovuar zhvillimin e bizneseve individuale dhe te vogla.
2. Komuna mund te ndajë subvencione per zhvillim ekonomik duke perfshire, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - 2.1 zeje bashkëkohore dhe tradicionale;
 - 2.2 agrobiznes;
 - 2.3 ndërmarrje publike;
 - 2.4 biznes inovativ;
 - 2.5 ndërmarrje sociale;
 - 2.6 aktivitetet e shoqatave që ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;
 - 2.7 bizneset e reja ose fillestare;
 - 2.8 aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore per zhvillim te biznesit;
 - 2.9 inkurajimin e punësimit te qendrueshem të gjinise së nenperfaqësuar ne kete sektor.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë ne Komunën e Fushe Kosoves.
4. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe te ATK-se.

Neni 7

Përparësite gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta, komuna u jep përparësi rasteve specifike, si në vijim:
 - 1.1 bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
 - 1.2 grave, të rinjve, veprimtarive në zona rurale, personave me nevoja te veçanta.

1.3 OJQ-ve të cilat aplikojnë me projekte biznesi, që mundësojnë gjenerim të vendeve
1.4 bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të një subvencioni për zhvillim ekonomik, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 2.1 planin e biznesit;
- 2.2 dokument identifikues;
- 2.3 certifikatën e vendbanimit (për persona fizike);
- 2.4 certifikatën e biznesit;
- 2.5 dëshminë për pagesën e taksave komunale;
- 2.6 dëshminë për pagesën e tatimit në pronë;
- 2.7 dëshminë se nuk ka obligime ndaj ATK-Se,
- 2.8 dëshminë për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim)
- 2.9 konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit).

3. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria perkatese.

Neni 8

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 1.1 projekte të fermerëve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën;
- 1.2 mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
- 1.3 projekte në sektorin e pylltarisë;
- 1.4 përkrahjen për zhvillim dhe turizëm rural.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

- 2.1 zonave me prioritet të identifikuara nga komuna;
- 2.2 pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me 20% të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
- 2.3 grave, të rinjëve, personave me nevoja të veçanta,
- 2.4 aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të ndonjë subvencioni për bujqësi, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 3.1 certifikatë të biznesit;

- 3.2 projektin dhe planin financiar;
 - 3.3 certifikatën e pronës;
 - 3.4 dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 3.5 dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 3.6 dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 3.7 konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;
 - 3.8 dokumentin identifikues të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit;
4. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- 4.1 dokumentin identifikues;
- 4.2 numrin identifikues të fermerit;
- 4.3 projektin dhe planin financiar;
- 4.4 certifikatën e pronësisë;
- 4.5 dëshminë për pagesën e taksave komunale;
- 4.6 dëshminë për pagesën e tatimit në pronë;
- 4.7 konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit.

5. **Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të percaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.**

Neni 9

Subvencionet në lëmin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

1. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Drejtoria subvencionon në forme të përkrahjes financiare qytetaret e Komunes së Fushe Kosovës për përballimin e shpenzimeve të shërimin nga sëmundjet e rënda, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, për renovimin e objekteve të banimit për qytetaret të cilët nuk e kanë të zgjidhur problemin e strehimit
2. Drejtoria subvencionon projektet dhe aktivitetet e organizatave të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
3. Ndarja e subvencioneve në lëmin e shëndetësisë sipas kritereve të kësaj rregulloreje do të aplikohet deri në hyrjen në fuqi të ligjit për sigurimet shëndetësore. Kriteret do të rishikohen pas hyrjes në fuqi të ligjit;

4. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim është si në vijim:

- 4.1. Personat me sëmundje të rënda dhe me kosto të lartë të shpenzimit të mjekimit e cila do të vlerësohet nga ekspertet mjekësor si pjesë e Komisionit Vlerësues;
- 4.2. Personat në gjendje të rëndë socio-ekonomike:

4.3. Perparësi kanë aplikuesit që janë nëna vetushqyese-bartëse të familjes;
4.4. Për raste e subvencionimit për renovimin e shtëpive, vlera maksimale është 6,000 € per aplikues.

4.5 Ndertimi dhe Rinovimi i shtëpive per Bashkfinancim .

5. Dokumentacioni i përgjithshëm:

5.1. Formulari i kërkesës / aplikacioni

5.2. Dokumentacioni mjekësor

5.3. Faturat për shpenzimet e mjekimit

5.4. Data e intervenimit të fundit

5.5. Diagnoza për të cilën po aplikon

5.6. Leternjoftimi (kopje) për të riturit

5.7. Ekstrakti i lindjes për të miturit

5.8. Konfirmimi bankar i llogarisë së aplikuesit

6. Kriteret specifike të detajuara të cilat do të publikohen në thirrjen për aplikim do të përpilohen nga Drejtoria dhe të miratohen nga Kryetari i Komunes.

Neni 10

Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport

1. Drejtoria subvencionon projektet dhe aktivitetet për personat fizik dhe juridik nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit të cilat janë të nderlidhura me programet e punës së Drejtorisë, me qëllim të avancimit të vlerave dhe fuqizimit të aktivitetëve kulturorë, sportivë dhe rinorë:

2. Drejtoria i shqyrton të gjitha kërkesat e personave fizik të Komunes, të cilët kërkojnë ndihmë financiare për realizimin e projekteve në fushën e Artit Figurativ, Teatrit, Muzikës, Filmit, Letërsisë, kërkesat për programet e aktivitetëve të Rinisë si dhe kërkesat në fushën e Sportit dhe përkujdeset për procesin e ndarjes së subvencioneve në harmoni me nenet paraprake të kësaj rregullore:

3. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim sipas fushave është si në vijim:

Fusha e Kulturës

3.1. Organizimin e aktivitetëve nga fusha e artit muzikor, letrar, filmik, dhe artit vizual - figurativ, krijim i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozitave, hulumtim sektoriale, instalime në hapësirat publike, mbështetje të personave me nevojë të veçanta dhe inovacion teknologjik.

3.2. Organizimi i koncerteve të muzikës artistike, koncerteve të ansambleve dhe grupeve muzikore të muzikës argëtuese, popullore, folklorike, etj:

3.3. Organizimi i aktivitetëve tradicionale dhe simpoziumeve të ndryshme ;

3.4. Subvencionimi i shoqatave dhe grupeve të artistëve, për hapjen e ekspozitave të ndryshme me vepra artistike;

3.5. Subvencionimi i kërkesave për botimin dhe promovimin e librave, si dhe për organizimin e Mitingut të Poezisë:

- 3.6. Subvencionimi për shenimin e datave të ngjarjeve historike;
- 3.7. Subvencionimi i projekteve të Teatrit të Oytetit, i projekteve të grupeve amatore të teatrove të kësaj Komune dhe grupeve të vallëzimit;
- 3.8. Subvencionimi i projekteve të Ansambllit Muzikor të Komunes së Fushe Kosoves.
- 3.9. Subvencionimi i projekteve të trashëgimisë kulturore, në fushata vetëdijësimi, pjesëmarrjes në aktivitet në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim i trashëgimisë kulturore, promovimi i diversitetit kulturor, turizem kulturor, platforma informative dhe inovacion teknologjik.

Fusha e Rinisë

- 3.10. Perkohja financiare e projekteve të OJQ-ve me fokus rinor, në përputhje me planin rinor lokal.
- 3.11. Fuqizimi i organizatave rinore: mbështetja e aktiviteteve të OJQ-ve, promovimi i vullnetarizmit integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, pjesëmarrje në seminare, konferenca etj., brenda dhe jashtë vendit, mbështetja e ideve -projekteve të rinjve, si dhe promovimi i talenteve të rinj;
- 3.12. Edukimi jo-formal; trajnime, punëtori debate, tryeza, ligjerata, hulumtime, simpoziume, konferenca et).
- 3.13. Shpërblime vjetore: vullnetari i vitit, ngjarja rinore e vitit, projekti rinor i vitit dhe organizata rinore e vitit.

Fusha e Sportit

- 3.14. Perkohja e qendrueshme financiare e klubeve sportive të Komunes, përmes subvencionimit të shpenzimeve të kuotizimit - regjistrimit në federatat përkatëse për pjesëmarrje në gara të kampionatit të republikës së Kosovës,
- 3.15. Bashkëpunimi me organizata dhe donatorë të ndryshëm me qëllim të ngritjes së cilësisë së sportistëve dhe trajnerëve të cilët angazhohen në punë në të gjitha kategoritë e grup moshave të sportistëve
- 3.16. Subvencionimi i kërkesave të klubeve apo Sportistëve të cilët garojnë si Individë për pjesëmarrje në gara Kombëtare dhe Ndërkombëtare;
- 3.17. Perkohja financiare e klubeve sportive të komunës, të cilat gjatë historikut të tyre kanë treguar rezultate të mira dhe vazhdojnë me paraqitje të suksesshme, por nuk kanë mundur të sigurojnë donacione për zhvillimin e aktiviteteve të tyre;
- 3.18. Subvencionimi i kërkesave të klubeve sportive për integrimin e komuniteteve minoritare në aktivitete sportive:
Përparsi në perkohje financiare kanë projektet e personave fizik dhe juridik që mbështesin promovimin e personave me aftësi të kufizuara.
Dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim për persona fizik / subvencionimi individual:
- 3.19. Kërkesa për subvencionim
- 3.20. Projekt propozimi me të dhënat e aplikuesit, arsyetimin përkatës, përshkrimin e aktiviteteve.
- 3.21. Specifikimi i shpenzimeve - Projekt Buxheti;
- 3.22. Letërnjoftimi i aplikuesit
- 3.23. Konfirmimi bankar për llogarinë e aplikuesit Dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim

per persona juridik:

3.24. Certifikata e regjistrimit te OJQ-së

3.25. Certifikatën e numrit fiskal

3.26. Vertetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet t'i dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit te rezultateve perfundimtare (pas publikimit te rezultateve preliminare te perfituesve)

3.27. Te ketë dorëzuar projekt propozimin te plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave te thirrjes publike

3.28. Te ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kerkesave te thirjes dhe te plotësuar në tërësi

3.29. Deklarate se OJQ-se se ka pergatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore (nëse kerkohet sipas thirjes)

3.30. Nje deklarate me te cilen tregojnë se i kanë permbushur detyrimet nga mbeshtetjet financiare publike të mëhershme (nëse kerkohet sipas thirjes)

3.31. Te dorezoje deklaratat e partneritetit ne rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet; (nese kerkohet sipas thirjes)

3.32. Te dergoje deshmi te implementimit të projekteve/programeve te ngjashme (nëse kerkohet sipas thirjes)

4. Kriteret Specifike të detajuara të cilat do te publikohen në thirrjen per aplikim do te perpilohen nga Drejtoria dhe do te miratohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 11

Subvencionimi nga Kabineti i Kryetarit

1. Kryetari i Komunes në formë të drejtperdrejte subvencionon për perkrahje financiare të personave fizik dhe juridik në fusha te papercaktuara .

2. Kryetari i Komunes sipas mundësisë buxhetore dhe interesit te pergjithshëm të Komunes; bashkefinancon projekte te cilal kerkojnë mbeshtetje financiare.

3. Për shqyrtimin e këtyre kerkesave per mbshtetje financiare, Kryetari i Komunes themelon një komisioni ad-hoc prej tre (3) anëtarëve.

Neni 12

Thirrja per Aplikim dhe Udhëzuesi per Aplikues

1. Njësia e kërkesës, ne rast të shperdarjes se subvencioneve perpilone thirrjen per aplikim dhe udhezuesin per aplikues sipas programit dhe planeve te tyre të punes,

2. Thirrja publike dhe udhezuesi per aplikues publikohet permes Zyrës per Informin duke u publikuar në faqen zyrtare të Komunes, rrjetet sociale të Komunes,

3. Udhëzuesi i thirries per aplikim duhet te perfs hij kriteret për perzgjedhjen e perfituesve;

4. Formulari per pershkrimin e projektit apo kërkesës;

5. Udhëzime për aplikantet duhet te japin informacion mbi arsyet dhe objektivat e thirjes,

kushtet e thirrjes, metodën e aplikimit dhe zbatimit të procedurës së thirrjes, dhe duhet të përfshinë informacionin në vijim:

5.1. Data e hapjes dhe mbylljes së thirrjes;

5.2. Te dhënat për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve dhe adresën për aplikim;

5.3. Te dhënat për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit;

5.4. Një përshkrim të problemit i cili synohet të adresohet përmes thirrjes;

5.5. Objektivat e përgjithshme të thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e burimeve financiare;

5.6. Një përshkrim të fushave në të cilat aplikanti mund të parashikojë zbatimin e programeve apo projekteve;

5.7. Shumat më të ulëta dhe më të larta financiare për projekt dhe kohëzgjatja e për implementimin e projekteve;

5.8. Aplikantët që kualifikohen për atë lloj të thirrjes, si dhe partnerët, nëse është e aplikueshme;

5.9. Parimet prioritare për dhenien e burimeve financiare në bazë të të cilave kanë përparësi në miratimin e fondeve, mund të ketë një kategori e veçantë e aplikantëve;

5.10. Aktivitetet e kualifikuara për zbatimin e programit ose projektit;

5.11. Kostot e pranueshme të cilat mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike

5.12. Shpenzimet e papranueshme që nuk mund të financohen nëpërmjet asaj thirrje publike;

5.13. Dokumentacioni i detyrueshëm dhe i jo detyrueshëm për aplikim në kuadër programit apo projektin, duke përfshirë formularët e nevojshëm për aplikim dhe dokumentacionin me të cilin **deshmohet plotësimi i kriterëve ligjorë për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike**

5.14. Kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të pyetjeve në lidhje me thirrjen dhe mënyrën e shpërndarjes dhe publikimit të përgjigjive në pyetjet e parashtruara.

5.15. Kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të ankesave.

5.16. Informacione mbi kontraktimin e projektit.

6. Udhëzimet e thirrjes mund të korrigojnë apo ndryshohen, por jo më vonë se shtatë (7) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve dhe të gjitha ndryshimet publikohen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin vend, si dokument baze;

7. Njësia e kërkesës mund të përdorë formularët e ofruara në Manualin për Implementimin e Rregullores MF-Nr 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;

8. Në varësi nga mitet financiare në dispozicionin nga njësitë kërkuese ato mund të përsëriten gjatë vitit kalendarik me shpalljen për ndarjen e subvencioneve.

Neni 13

Kufizimet në aplikim dhe perzgjedhje për financim

1. Për rastet e kërkesave të cilat e kalojnë vlerën prej 15,000.00 euro, kërkesa duhet të parashtrohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunes, një herë gjatë vitit kalendarik.
2. Personat fizik mund të përfitojnë subvencione deri në vlerën prej 5.000.00 euro.
3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues nëse për të njëjtin aktivitet ka përfituar nga institucionet apo donatorët tjerë;
4. Përfituesi nuk mund të jetë nën hetim, i bankrotuar apo të jetë i mbyllur, administrim të gjykatave, të ketë pezulluar aktivitetet afariste, apo të jetë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje;

5. Perfituesit, perkatësisht personat fizik dhe perfaqësuesit e personave juridik nuk mund te jene te dënuar per nje veper që ka te bëje me sjelljen profesionale me aktgjykim te plotfuqishem;

Neni 14

Procedura e Shqyrtimit të Aplikacioneve/Kerkesave

1. Procedurat per shqyrtimin e aplikacioneve/kerkesave jane:
- 1.2. Dorëzimi i aplikacionit/kerkeses nga aplikanti ne adresen e percaktuar ne udhezues:
- 1.2. Pranimi i aplikacioneve/kerkesave;
- 1.3. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve/kerkesave;
- 1.4. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve kerkesave;
- 1.5. Shpallja publike e rezultateve preliminare te vlerësimit te aplikacioneve/kerkesave:
- 1.6. Periudha e ankimit / e drejta e ankesës;
- 1.7. Kontrolla e parë në terren, per subvencionimin e projekteve;
- 1.8. Miratimi i projekteve;
- 1.9. Njoftimi i aplikuesit me rezultatin e vlerësimit të projektit;
- 1.10. Vendimi;
- 1.11. Nënshkrimi i kontrates ne mes te perfituesit dhe Komunës;
- 1.12. Dorëzimi i kërkeses per pagesë nga perfituesi ne Komune;
- 1.13. Kontrolla e dyte ne terren;
- 1.14. Masat ndëshkimore në rast te parregullsive gjate zbatimit te projekteve;
- 1.15. Ekzekutimi i pagesës;
- 1.16. Monitorimi pas zbatimit te projektit.
2. Shqyrimi administrativ kompletohet brenda 30 ditëve kalendarike;
3. Për projektet, vleresimi dhe poentimi i aplikimeve të praneshme duhet të kryhet brenda 45 diteve kalendarike;
4. Të githe aplikuesit duhet të informohen për perzgjedhjen ose refuzimin e projektit/kerkesës së tyre;

Neni 15

Komisioni Vlerësues

1. Perzgjedhja e përfituesve behet nga komisioni vlerësues i propozuar nga ana e njësisë kerkuese dukë u aprovuar me vendim nga ana e Kryetarit të Komunës;
2. Komisioni vlerësues perbehet nga 3 anëtare, përkatesisht një (1) anetare nga njesia kerkuese njëri prej tyre kryesues i komisionit, 1 (nje) anëtar nga njera prej drejtorive të Komunes, dhe 1 (një) anëtar nga Shoqeria me thirrjen per aplikim; Civile i/e cili/cila gjate perzgjedhjes prioritet kanë ata te cilet veprojnë në fushën relevante me thirrjen per aplikim
3. Pervec anëtarëve te rregullt të komisionit vlerësues nga paragrafi 2, duhet të parashihet edhe nje (1) anëtar rezervë i cili do të zëvendësoj anëtarin e komisionit vlerësues ne raste te mungesës, semundjes, konflikti i interesit. dhe te ljera;
4. Perberja e komisionit vlerësues duhe te ketë perfaqësim gjinor.
5. Komisioni vlerësues nuk eshte organ i perhershem, por emërohet pas publikimit të thirrjes per

aplikim dhe shpërbëhet menjëherë pas perfundimit të procedurës së vlerësimit.

6. Komisioni vlerësues është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtë dhe listës së përfituesve përfundimtar;

7. Në përfundim të procedurës së vlerësimit Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave përpilon një raport/procesverbal të punës dhe të njëjtin e dorëzon tek Drejtori i njesisë përkatëse, i/e cili/a mbi bazën e rekomandimeve nga raporti, ia përcjell dokumentacionin Kryetarit për vendimmarrje.

8. Në raste të veçanta. Kryetari mund të kërkojë që komisioni vlerësues të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulohet gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 16

Sherbimet Administrative për Komisionin

1. Njësia e kërkesës shërben si sekretar për Komisionin Vlerësues dhe ka këto përgjegjësi:

1.1 Përcakton datën e fillimit të procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, jo më vonë se pesë (5) ditëve të punës;

1.2 Siguron informata, materiale përcjellese, si dhe udhëzime procedurale për anëtarët e Komisionit;

1.3 Bënë publikimin e rezultateve në përputhje me rregulloren për transparencë dhe komunikon me përfituesit sipas raportit vlerësues.

Neni 17

Kriteret e përgjithshme për aplikim

1. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm që kërkohet nga aplikuesit për të përfituar të drejtën për subvencionim sipas fushave përkatëse i saktësuar në këtë rregullore është indicative, dhe ajo do të përcaktohet në detaje përmes thirrjes publike, varesisht nga natyra e thirrjes, kushtet jera të thirrjes dhe situata aktuale para publikimit të thirrjes.

2. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

3. Implementimi i aklliviteleve të parapara në projektet e subvencionuara duhet të bëhet vetëm në territorin e Komunitetit të Fushe Kosovës

4. Projektet që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, dhe komunitetet joshumice kanë përparësi në fushat që i mbulojnë .

Neni 18

Monitorimi

1. Të gjithë përfituesit obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese e parapare në kontratë.

2. Njësia e kërkesës formon komisionin monitorues të përbërë nga tre (3) anëtarë për monitorimin e të gjitha projekteve/subvencioneve të financuara:

3. Anëtarët e komisionit vlerësues nuk mund të caktohen në komisionin monitorues .

4. Procesi i monitorimit, periudha kohore e monitorimit, dhe veprimet e tjera me interes për njesinë kërkuese, duhet të specifikohet në marrëveshjen e nënshkruar në mes të njesisë kërkuese dhe përfituesit:

5. Gjatë monitorimit të projektit, nëse konstatohet se përfituesi nuk i mirëmban investimet,

atëherë ai/ajo do të procedohet sipas procedurave ndëshkimore të percaktuara në kontratë, dhe i njëjti do të vendoset në listën e personave/bizneseve që nuk do të perzgjidhen për perkrrahje në të ardhmen nga Komuna.

Neni 19 **Ankimimi**

1. Aplikuesit e pakënaqur me rezultatin e vlerësimit kanë të drejtën e ankesës, dhe ato në afatin prej 7 ditësh nga dita e publikimit të listës preliminare të perfituesve;
2. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës, duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës;
3. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij, me të cilin:
 - 3.1. Vërteton vendimin e njësisë së kërkesës në lidhje me vlerësimin e projektit perkates.
 - 3.2. Anulon vendimin e njësisë së kërkesës në lidhje me vlerësimin e aplikacionit/kërkesës perkates dhe merr vendim meritore në lidhje me projektin perkates.
 - 3.3. Kthen për rivlerësim në njësinë e kërkesës projektin perkates.
4. Gjate procesit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave mund të kërkojë informacione të nevojshme nga njësia e kërkesës, si dhe të realizojë vizita në teren në [lidhje me projektet perkatese](#).

Neni 20 **Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave**

1. Komisioni themelohet me vendim të Kryetarit të Komunes, sipas të cilit percaktohen mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
2. Komisioni do të jetë në përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe të ketë përfaqësim gjinor. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve perbehet nga dy shërbyes civil, nga të cilët një anëtar duhet të jetë zyrtar ligjor, ndërsa anëtar i tret duhet të jetë nga Shoqëria Civile;
3. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e mbajtura i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
4. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve, nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

Neni 21 **Dispozitat Kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me miratimin e kësaj Rregulloreje, Shfuqizohet Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve nr. 01/011-11268 e dt. 07.07.2014 dhe Rregullorja për Plotësim Ndryshimin e Rregulloreve për Ndarjen e Subvencioneve nr. 01/011-37911 e dt. 04.06.2015;
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të perkujdeset Kryetari i Komunës dhe të gjitha Drejtorit dhe Zyret të cilat shperdajne subvencione;

3. Kjo regullore hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit ne zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokal, si dhe publikimit ne gjuhe zyrtare ne ueb faqen e komunes.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo regullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunes së Fushe Kosoves dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit ne Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokal, si dhe shtate (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Fushe Kosoves.

KUVENDI I KOMUNES SE FUSHË KOSOVË

KRYESUESI I KUVENDIT

01-Nr-_____, më _____.

Vlonjat Hasani
